

STATUTII SHOQERISE
“MED Laborator Tirana” Sh.p.k

Ne kete statut

- "Ligji" eshte Ligji Nr. 9901, dt. 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite tregtare";
- "Statuti" eshte Statuti i shoqerise;

Kreu I

Themelimi, Emri, Objekti, Kohezgjatja, Selia

Neni 1

Data e Themelimit, Emri dhe Themeluesit

Sot, me datë 25.03.2021 ne, themeluesit, kemi krijuar nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar me emrin “MED Laborator Tirana” SH.P.K.

Themeluesit e shoqërisë janë:

- **Z. Erion Mita**, shtetas shqiptar, lindur më 17.06.1971 në Tiranë, identifikuar me leternjoftim, me nr personal H10617144R madhor e me zotësi të plotë për të vepruar.
- **Znj. Majlinda Kokiçi**, shtetase shqiptare, lindur më 30.04.1973 në Shkodër, identifikuar me leternjoftim, me nr personal H35430113M madhore e me zotësi të plotë për të vepruar.

Neni 2

Objekti

Shoqeria do te kryeje aktivitetin e meposhtem:

2.1. Laborator mjekësor.

2.2 Gjithashtu shoqëria mund te kryeje cdo lloj veprimtarie tjetër që është në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe që siguron fitime dhe të ardhura të ligjshme brenda kufijve të parashikuar nga legjislacioni në fuqi, si dhe mund të kryejë cdo operacion tregtar dhe financiar, që lidhet drejtpërdrejtë ose tërthorazi me objektin e saj.

2.3 Shoqëria, me vendim të Asamblesë, mund të lidhë marrëveshje tregtare apo bashkëpunimi me shoqëri apo sipërmarrje të tjera, si dhe të kryejë cdo veprim tregtar që konsiderohet i nevojshëm me qëllim arritjen e objektit të veprimtarisë së saj.

Neni 3
Kohezgjatja

Kohezgjatja e shoqerise do te jete pa afat.



Neni 4 Selia

Selia e shoqerise ndodhet ne adresen: "Tirane, Rruga Siri Kodra, Pallati A&A, Korpusi A, Kati perdhe."

Kreu II Kapitali

Neni 5 Kapitali themeltar

Kapitali themeltar fillestar i shoqerise eshte 1.000 (njemijë) leke dhe nuk eshte paguar. Pjesemarrja e themeluesve ne kapitalin e shoqerise eshte si me poshte:

- Z. Erion Mita, shtetas shqiptar, lindur më 17.06.1971 në Tiranë, identifikuar me leternjoftim, me nr personal H10617144R madhor e me zotësi të plotë për të vepruar, zotëron 1 (një) kuotë dhe 51% (pesëdhjetë e një përqind) te kapitalit themeltar te shoqerise.

- Znj. Majlinda Kokiçi, shtetase shqiptare, lindur më 30.04.1973 në Shkodër, identifikuar me leternjoftim, me nr personal H35430113M madhore e me zotësi të plotë për të vepruar, zotëron 1 (një) kuotë dhe 49% (dyzetë e nëntë përqind) te kapitalit themeltar te shoqerise.

Neni 6:

Zmadhimi dhe zvogelimi i kapitalit

Kapitali i shoqerise mund te zmadhohet nepermjet nenshkrimeve te pjeseve te kapitalit themeltar per kontributet ne para dhe me ane te kontributeve ne natyre, nepermjet emerimit nga gjykata kompetente e nje eksperti te autorizuar per keto kontribute sipas kerkeses se administratorit.

Ne asnje rast shumica nuk mund te detyroje nje ortak per te rritur angazhimin e tij ne kapitalin themeltar te shoqerise.

Zvogelimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakeve, e cila merr vendim ne te njejtat kushte qe kerkohen per ndryshimin e statutit.

Ne te gjitha rastet zvogelimi i prek ortaket ne te njejtën mase ndaj pjeseve te kapitalit qe perfaqesojne.

Neni 7

Shperndarja e fitimeve

Fitimi i destinuar per t'u shperndare ndërmjet ortakëve ne baze te vendimit te asamblese perkatese, do ndahet midis ortakeve në mënyrë të barabartë, në raportin 50% me 50% pavaresisht nga perqindja e pjesemarrjes se ortakeve ne kapitalin e shoqerise.



Neni 8 Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit te shoqerisë e te drejtat qe rrjedhin prej tyre mund te fitohen apo kalohen nepermjet:

- 1.kontributit ne kapitalin e shoqerise;
- 2.shitblerjes;
- 3.trashegimise;
- 4.dhurimit;
- 5.cdo menyre tjeter te parashikuar me ligj.

Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme ndermjet ortakeve, per sa nuk parashikohet ndryshe ne statut.

Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme me rruge trashegimie.

KREU III ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE

Neni 9 Organi Vendimmarres

Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise.

Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara ne ligj.

Asambleja e pergjithshme e ortakeve eshte pergjegjese per marrjen e vendimeve per shoqerine per ceshtjet e meposhtme:

- a) percaktimin e politikave tregtare te shoqerise;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emerimin e shkarkimin e administratoreve;
- d) emerimin e shkarkimin i likuiduesve dhe te eksperteve kontabel te autorizuar;
- dh) percaktimin e shperblimeve per personat e permendur ne shkronjat "c" dhe "5" te kesaj pike;
- e) mbikeqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga administratoret, perfshire pergatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
- f) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
- g) zmadhimin dhe zvogelimin e kapitalit;
- gj) pjesetimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- h)perfaqesimin e shoqerise ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratoreve;
- i) riorganizimin dhe prishjen e shoqerise;
- j)miratimin e rregullave procedurale te mbledhjeve te asamblese;
- k)ceshtje te tjera te parashikuara nga ligji apo statuti.

Ortaku mund te perfaqesohet ne asamblene e pergjithshme, ne baze te nje autorizimi nga nje ortak tjeter apo nga nje person i trete.

Administratori i shoqerise nuk mund te veprojne si perfaqesues i ortakeve ne asamblene e pergjithshme.

Autorizimi mund te jepet vetem per nje mbledhje te asamblese se pergjithshme, e cila perfshin edhe mbledhjet vijuese me te njejtin rend dite.



Neni 10
Menyra e thirrjes se mbledhjes se Asamblese se Pergjithshme

Asambleja e pergjithshme thirret nepermjet nje njoftimi me shkrese ose, me njoftim nepermjet postes elektronike. Njoftimi me shkrese apo me mesazh elektronik duhet te permbaje vendin, daten, oren e mbledhjes dhe rendin e dites e t'u dergohet te gjithe ortakeve, jo me vone se 7 dite perpara dates se parashikuar per mbledhjen e asamblese.

Kur asambleja e pergjithshme nuk eshte thirrur si me siper, ajo mund te marre vendime te vlefshme vetem nese te gjithe ortaket jane dakord, per te marre vendime, pavaresisht parregullsisë.

Neni 11
Kuorumi

Ne rastin e marrjes se vendimeve, qe kerkojne nje shumice te zakonshme, asambleja e pergjithshme mund te marre vendime te vlefshme vetem nese marrin pjese ortaket me te drejte vote, qe zoterojne me shume se 30 per qind te kuotave.

Ne rastin kur asambleja e pergjithshme duhet te vendose per ceshtje, te cilat kerkojne shumice te kualifikuar sipas nenit 87 te ligjit " Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare ", ajo mund te marre vendime te vlefshme vetem, nese ortaket qe zoterojne me shume se gjysmen e numrit total te votave, jane te pranishem personalisht, votojne me shkrese, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve te pikes 3 te nenit 88 te ketij ligji.

Nese asambleja e pergjithshme nuk mund te mblidhet per shkak te mungeses se kuorunit te permendur me lart, asambleja mblidhet perseri jo me vone se 30 dite, me te njejtin rend dite.

Neni 12
Marrja e vendimeve

Asambleja e pergjithshme vendos me tri te katertat e votave te zoteruesve te kapitalit, te ortakeve pjesemarres, per ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit te regjistruar, shperndajjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqerise.

Asambleja e pergjithshme vendos me shumicen e votave te ortakeve pjesemarres, per ceshtje te tjera si:

- a) percaktimi i politikave tregtare te shoqerise;
- b) emerimin dhe shkarkimin e administratoreve;
- c) emerimin e shkarkimin i likuiduesve dhe te eksperteve kontabel te autorizuar;
- d) mbikeqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga administratoret, perfshire pergatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
- e) perfaqesimin e shoqerise ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratoreve;
- f) miratimin e rregullave procedurale te mbledhjeve te asamblese;

Cdo ndryshim statuti duhet te depozitohet prane QKR per te pasqyruar ndryshimet ne skeden e shoqeri

Neni 13

Perjashtimi nga e drejta e votes

Ortaku nuk mund te ushtroje te drejten e votes nese asambleja e pergjithshme merr vendim per:

- a) vleresimin e veprimtarise se tij;



- b) shuarjen e ndonje detyrimi ne ngarkim te tij;
- c) ngritjen e nje padie ndaj tij nga shoqeria;
- d) dhenien ose jo te perfitimeve te reja.

Kur ortaku perfaqesohet nga nje perfaqesues i autorizuar, i autorizuari vleresohet te jete ne te nejtin konflikt interesi, ashtu si dhe ortaku, te cilin perfaqeson.

Neni 14 Administrimi

13.1 Personi i meposhtem caktohet si Administrator i pare i shoqërisë:

Z. Erion Mita, shtetas shqiptar, lindur më 17.06.1971 në Tiranë, identifikuar me leternjoftim, me nr personal H10617144R madhor e me zotësi të plotë për të vepruar.

13.2 Administratori i Shoqërisë do të ushtroje kompetencat e tij në këtë detyrë për një periudhe 5 (pesë) vjecare, me të drejtë ripërtëritjeje.

13.3 Znj.Majlinda Kokiçi caktohet si drejtues teknik i shoqërisë.

Neni 15 Kompetencat e Administratorit

Administratori ka te drejte e detyrohet te:


- a) kryeje te gjitha veprimet e administrimit te veprimtarise tregtare te shoqerise, duke zbatuar politikat tregtare, te vendosura nga asambleja e pergjithshme;
- b) perfaqesoje shoqerine tregtare;
- c) kujdeset per mbajtjen e sakte e te rregullt te dokumenteve dhe te librave kontabel te shoqerise;
- ç) pergatit dhe nenshkruan bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurise se veprimtarise dhe, se bashku me propozimet per shperndarjen e fitimeve, i paraqesin keto dokumente perpara asamblese se pergjithshme per miratim;
- d) krijon nje sistem paralajmerimi ne kohen e duhur per rrethanat, qe kercenojne mbarevajtjen e veprimtarise dhe ekzistencen e shoqerise;
- dh) kryen regjistrimet dhe dergon te dhenat e detyrueshme te shoqerise, si parashikohet ne ligjin per Qendren Kombetare te Regjistrimit;
- e) raporton perpara asamblese se pergjithshme ne lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve te posacme me rendesi te vecante per veprimtarine e shoqerise tregtare;
- e) kryen detyra te tjera te percaktuara ne ligj dhe ne statut.

Neni 16 Pergjegjesite e Administratorit

Administratori eshte pergjegjes individualisht, ndaj shoqerise ose ndaj te treteve, per shkelje te ligjeve, per shkelje te statutit, apo per faje te kryera gjate administrimit te shoqerise. Pasojat e marreveshjeve te pamiratuara nga asambleja qe i sjellin dem shoqerise, i ngarkohen administratorit dhe ortakut qe ka bere marreveshjen, per te perballuar ne menyre individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat perkatese.

Pervec sa eshte parashikuar ne dispozitat e pergjithshme te detyrimit te besnikerise, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 te ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", administratori detyrohet:

- a) te kryeje detyrat e tij te percaktuara ne ligj dhe ne statut ne mirebesim e ne interesin me te



- mire te shoqerise ne teresi, duke i kushtuar vemendje te vecante ndikimit te veprimtarise se shoqerise ne mjedis;
- b) te ushtroje kompetencat qe i njihen ne ligj dhe ne statut vetem per arritjen e qellimeve te percaktuara ne keto dispozita;
- c) te vleresoje me pergjegjesi ceshtjet, per te cilat merret vendim;
- ç) te parandaloje dhe menjanoje rastet e konfliktit, prezent apo te mundshem, te interesave personale me ata te shoqerise;
- d) te ushtroje detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshem.

Kreu IV Viti financiar

Neni17

Viti Financiar

Viti financiar i Shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne Qendren Kombetare te Biznesit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

Kreu V Prishja-riorganizimi i shoqerise

Neni18

Prishja dhe likuidimi

Shperndarja ose prishja e shoqerise mund te behet ne cdo kohe:

- a) me vendim te Asamblese se Ortakeve;
- b) me hapjen e procedurave te falimentimit;

Neni19

Riorganizimi i shoqerise bashkimi-ndarja

Shoqeria mund te ndahet, bashkohet sipas Vendimit te Mbledhjes se Pergjithshme te Asamblese se Ortakeve, ne perputhje me dispozitat ligjore te parashikuara ne Pjesen IX te Ligjit 9901 date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare."

Neni 20

Baza Ligjore

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e tij ne perputhje te plote me kete statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Per sa nuk parashikohet ne kete statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", Kodit Civil dhe cfaredo ligji tjetër specifik ne Republikën e Shqipërisë.



Neni 21

Mosmarreveshjet

Per mosmarreveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij statuti, si dhe per cdo mosmarreveshje qe mund te linde midis Shoqerise dhe te treteve, do te jete kompetente Gjykata Shqiptare e Rrethit Gjyqesor Tirane.

NENI 22

Kopjet

Ky dokument redaktohet ne 3 (tre) kopje origjinale.


Lexuar, kuptuar, aprovuar e nenshkruar nga ortakët themelues.

ORTAKËT THEMELUES

Z. Erion Mita

Handwritten signature of Z. Erion Mita in black ink, written over a horizontal line.

Znj. Majlinda Kokiçi

Handwritten signature of Znj. Majlinda Kokiçi in black ink, written over a horizontal line.

**AKT THEMELIMI
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**

“MED Laborator Tirana” Sh.p.k

I. THEMELIMI

**NENI 1
Ortakët themelues**

Shoqeria krijohet nga ortakët themelues:

- **Z. Erion Mita**, shtetas shqiptar, lindur më 17.06.1971 në Tiranë, identifikuar me leternjoftim, me nr personal H10617144R madhor e me zotësi të plotë për të vepruar.

- **Znj. Majlinda Kokiçi**, shtetase shqiptare, lindur më 30.04.1973 në Shkodër, identifikuar me leternjoftim, me nr personal H35430113M madhore e me zotësi të plotë për të vepruar.

II. EMERTIMI – SELIA – FORMA JURIDIKE - OBJEKTI

**NENI 2
Emertimi**

Shoqeria emertohet “MED Laborator Tirana” Sh.p.k

**NENI 3
Forma juridike**

Forma juridike do te jete shoqeri me pergjegjesi te kufizuar (Sh.p.k.) sipas Ligjit nr.9901 date 14.04.2008 “Per tregtarët dhe shoqerite Tregtare”.

**NENI 4
Selia**

4.1 Shoqeria “MED Laborator Tirana” Sh.p.k e ka seline e saj ne adresen: *Tirane, Rruga Siri Kodra, Pallati A&A, Korpusi A, Kati perdhe.*

4.2 Shoqeria vepron si person juridik shqiptar dhe si e tillë mund te kryeje aktivitetin e saj ne te gjithë territorin e Republikës se Shqiperise ose jashte saj, nepermjet filialeve, degeve, zyrave te perfaqesimit ose agjensite e saj, te cilat jane krijuar me vendim të Asamblesë së Pergjithshme të Shoqerise dhe do te veprojnë nen mbikqyrjen e Administratorëve të “MED Laborator Tirana” Sh.p.k.



NENI 5

Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë

- 5.1. Shoqëria "MED Laborator Tirana" Sh.p.k ushtron veprimtarinë e saj me qëllim realizimin e fitimit, duke u mbështetur në parimet dhe rregullat e parashikuara nga legjislacioni shqiptar.
- 5.2. Veprimtaria e Shoqërisë "MED Laborator Tirana" Sh.p.k, do të ketë për objekt: *Laborator mjekësor*.
- 5.3 Shoqëria mund të kryejë çdo lloj veprimtarie tjetër që është në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe që siguron fitime dhe të ardhura të ligjshme brenda kufijve të parashikuar nga legjislacioni në fuqi, si dhe mund të kryejë çdo operacion tregtar dhe financiar, që lidhet drejtpërdrejtë ose tërthorazi me objektin e saj;
- 5.4 Shoqëria, me vendim të Asamblesë, mund të lidhë marrëveshje tregtare apo bashkëpunimi me shoqëri apo sipërmarrje të tjera, si dhe të kryejë çdo veprim tregtar që konsiderohet i nevojshëm me qëllim arritjen e objektit të veprimtarisë së saj.
- 5.5 Objekti i shoqërisë mund të ndryshojë, të zgjerohet ose të pakesohet në bazë të vendimit të Asamblese së Përgjithshme.

III. KOHEZGJATJA – KAPITALI I SHOQËRISË-VENDIMARRJA

NENI 6

Kohezigjatja

Shoqëria do të zhvillojë veprimtarinë për një periudhë kohore të pacaktuar.

NENI 7

Kapitali i Shoqërisë

- 7.1 Kapitali themeltar i shoqërisë "MED Laborator Tirana" Sh.p.k perfaqësohet nga 2 (dy) kuota me vlerë 1000 (njëmijë) leke dhe nuk është paguar.
- Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë:
- Z. Erion Mita : Zotues i 1 (një) kuote që përben 51 % (pesëdhjetë e një përqind) të kapitalit themeltar të shoqërisë.
 - Znj. Majlinda Kokiçi: Zotuese e 1 (një) kuote që përben 49 % (dyzet e nëntë përqind) të kapitalit themeltar të shoqërisë.



NENI 8

Asambleja e Pergjithshme

Vendimet merren nga Asambleja e Pergjithshme. Asambleja e Pergjithshme merr vendime per ceshtjet qe ligji apo Statuti i'a rezervon ketij organi, si dhe per ceshtjet per te cilat, Administratori kerkon mendimin apo miratimin e Asamblesë së Pergjithshme.

8.1 Vendimet e Asamblesë së Pergjithshme merren me shkrim dhe regjistrohen ne nje regjister te posacem te mbajtur prane selise se Shoqerise "MED Laborator Tirana" Sh.p.k.

8.2 Jane ne kompetencen ekskluzive te Asamblese së Ortakëve marrja e vendimeve per sa i perket:

- ndryshimit të Statutit;
- riorganizimi i shoqerise, ndarja, bashkimi, likuidimi, shnderrimi i shoqerise;
- zmadhimi, zvogelimi i kapitalit, transferimi i pjeseve te kapitalit themeltar tek të tretët, si dhe blerjen e pjeseve te kapitalit themeltar nga vete shoqeria me qellim anullimin e tyre;
- emerimi dhe shkarkimi i Administratorit;
- emerimi dhe shkarkimi i eksperteve kontabel te autorizuar;
- miratimi e bilancit;
- si dhe te gjitha kompetencat e tjera qe ligji dhe/ose Statuti japin shprehimisht Asamblese

NENI 9

Organet drejtuese

Organet drejtuese të Shoqerisë janë:

- a) Asambleja e Pergjithshme në të cilën marrin pjesë Ortakët e Shoqerisë ose përfaqësuesit e tyre të pajisur më prokurë të veçantë; dhe
- b) Administratorët

NENI 10

Administratori i Shoqerisë

10.1 Shoqeria administrohet nga Administratori, person fizik qe mund te jetë ose jo ortak i Shoqerisë.


10.2 Administratori eshte të detyruar të drejtojë Shoqërinë në përputhje me ligjin "Për tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", Statutin, vendimet e Asamblesë së Pergjithshme dhe sipas dispozitave të tjera ligjore në fuqi.

10.3 Administratori i Shoqerisë emerohet dhe shkarkohet nga Asambleja e Ortakëve, si dhe do te qendroje ne detyre per një kohë prej 5 (pese) vjetesh me të drejtë ripërtëritje.

10.4 Administratori i pare i shoqerisë emerohet:

Z. **Erion Mita**, shtetas shqiptar, lindur më 17.06.1971 në Tiranë, identifikuar me leternjoftim, me nr personal H10617144R madhor e me zotësi të plotë për të vepruar.

Nënshkrimi i administratorit

Erion Mita 

11.5 Administratori ka te gjitha kompetencat qe i nje ligji dhe Statuti i Shoqerise.

11.6 **Znj.Majlinda Kokiçi** caktohet si drejtues teknik i shoqerisë.

NENI 11

Ligji i zbatueshem dhe mosmarreshjet

- 11.1 Per sa nuk parashikohet nga ky Akt Themelimi, reference i behet legjislacionit shqiptar ne fuqi.
11.2. Per te gjitha mosmarreshjet brenda shoqerise qe mund te lindin gjate veprimtarise se shoqerise dhe qe nuk mund te zgjidhen me mirekuptim, organi kompentent do te jete Gjykata e Rrethit Gjyqesor Tirane.
11.3. Ky dokument redaktohet ne 3 (tre) kopje origjinale.


Lexuar, kuptuar, aprovuar e nenshkruar nga ortaket themelues.

ORTAKËT THEMELUES

Z. Erion Mita

Erion Mita


Znj. Majlinda Kokiçi

Majlinda Kokiçi


Tiranë, më 25.03.2021